

NEWSLETTER

Nëntor

A E DINI SE ...!

Në muajin Tetor
është zhvilluar censusi
i popullsisë dhe banesave!

Reminder/
3 Vite nga tërmeti i
fuqishëm në Shqipëri



E-mail-et
falenderuese të klientëve
të rasteve të tërmetit
të 26 Nëntorit

Përse duhen
paketat e sigurimit të
apartamentit/shtëpisë/vilave?

Albsig: Bli online
sigurimin e shtëpisë,
fito falas kartën
Albsig MED"

Med-Kartë,
Mundësi Lehtësuese
për Shëndetin

Albsig, mbështet
panairin ndërkombëtar
të bujqësisë, blegtorisë
dhe kopshtarisë 2022.

Albsig Jetë;
nismë në fakultete në kuadër të
"sigurimi jetë studentë"

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.





Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP

A E DINË SE ...!

NË MUAJIN TETOR ËSHTË ZHVILLUAR CENSUSI I POPULLSISË DHE BANESAVE!



Instat njoftoi se Tetori ishte muaji që do të startojë me fillimet e punës për Censusin e Popullsisë. Censusi i Popullsisë dhe Banesave për vitin 2022 do të jetë Censusi i 12-të, që kur Shqipëria u shpall shtet i pavarur në vitin 1912, ku Censusi i parë u krye në vitin 1923. Që prej Censurit të vitit 1989, metodologjia e tij ka ndjekur gjithnjë e më shumë rekomandimet ndërkombëtare për kryerjen e tij. Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2022 synon të jetë në përputhje të plotë me rekomandimet e Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) për raundin e vitit 2020 të Censuseve dhe gjithashtu me rregulloret e fundit të BE-së për zbatimin e Censurit të Popullsisë dhe Banesave.

Çfarë Është Censusi?

Censusi i Popullsisë dhe Banesave ofron të dhëna mbi numrin zyrtar të popullsisë në një vend, në njësinë më të vogël gjeografike, së bashku me informacionin mbi një numër të zgjedhur të karakteristikave demografike, sociale dhe ekonomike të popullsisë. Secili qytet do t'i ketë të specifikuar të dhënat e tij, si për popullsinë, ashtu dhe për banesat dhe tipologjinë e tyre.

Çfarë Është Censusi i Banesave?

Në mënyrë të ngjashme, Censusi i banesave ofron numërimin zyrtar të të gjitha banesave në vend në njësinë më të vogël gjeografike, së bashku me informacionin mbi një numër të zgjedhur të karakteristikave të banesave.

Kur do të Kryhet Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2022?

Censusi i Popullsisë dhe Banesave do të zhvillohet në Tetor 2022. Puna në terren do të zgjasë gjashtë javë.

Risitë e Censurit 2022:


1. Përdorimi i pajisjeve elektronike (tableta), të cilat do të zëvendësojnë pyetësorët letër për procesin e mbledhjes së të dhënave në terren;
2. Modernizimi i Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS) — mbledhja, monitorimi, analiza dhe shpërndarja e të dhënave;
3. Censusi do të shërbejë si bazë për konceptimin dhe krijimin e regjistrave statistikorë të popullsisë banuese, ndërtesave dhe banesave.

Rëndësia e Censurit të Popullsisë dhe Banesave

Censusi i Banesave është shumë i rëndësishëm sepse specifikon rëndësinë dhe llojin e zonave, për ato që do të bëhen ndërtime dhe për ato që ekzistojnë si ndërtime.

Për ndërtimet e reja do të bëjë të mundur llojin specifik të saj, edukimin e konsumatorëve dhe rëndësinë e sigurimit të çdo ndërtese si aktuale ashtu dhe ato të reja që mendohen të bëhen në të ardhmen.

Censusi grumbullon informacion për secilin anëtar të familjes lidhur me nivelin e arsimit, punësimit, gjendjes ekonomike si dhe informacion për situatën e strehimit duke përfshirë llojin e banesës, statusin ligjor, gjendjen fizike, infrastrukturën e brendshme dhe të jashtme si dhe sipërfaqen e banesës.





REMINDER/3-VITE NGA TËRMETI I FUQISHËM NË SHQIPËRI

Startoi i treti vit nga tërmeti më i fuqishëm që tronditi Shqipërinë. Ende gjurmët e këtij të fundit janë jetëzuar në këto katër vite, rrënojat ende janë të freskëta në siluetën e qytetit të Durrësit dhe të Tiranës. Banorët e këtyre qyteteve enden nëpër zyrat e shtetit për të marrë një përgjigje për strehim. Nxënësit e shkollave të Tiranës mësojnë me turne sepse një pjesë e godinave të shkollave ende "lëngojnë" nga pasojat e tërmetit. Në memorien e gjithësecilit prej nesh është e freskët ajo ditë.

Ishte ora 03:56, kur një lëkundje e fuqishme me magnitudë 6.4 të shkallës rihter, që zgjati për rreth 50 sekonda, goditi Durrësin dhe Tiranën dhe disa bashki të tjera, duke iu marrë jetën 51 personave dhe plagosur qindra të tjerë. Pasojat e këtij tërmeti tronditës ishin akoma më tragjike, pasi u prekën plot 202 mijë njerëz, teksa u shkatërruan qindra banesa. Epiqendra e tërmetit 6.4 ballë, ishte në Durrës. Fillimisht vendi u godit nga një valë më pak e fuqishme për t'u ndjekur nga një tjetër që u ndje në gjithë vendin dhe përreth. Qindra godina u shembën duke zënë poshtë qytetarë, pak prej të cilëve ishin aq me fat sa që t'i mbijetonin orëve të tëra në mungesë oksigjeni dhe peshë mbi trupat e tyre.

Familja më e dëmtuar nga lëkundjet e tokës, ishte ajo e Albert Carës. Kryefamiljari është personi i vetëm që i shpëtoi rrënimin të godinës ku jetoi prej vitesh, por humbi 9 anëtarët e familjes. Albert Cara, nga Thumana dëshironte që të qëndronte vetë pranë forcave speciale teksa gërrmonin nën rrënoja, por edhe gjendja e tij u përkeqësua, ndaj u dërgua në Itali për mjekim më të specializuar. Për disa muaj, Cara qëndroi jashtë vendit me idenë se kur të kthehej do të takohej me fëmijët e tij dhe me bashkëshorten. 51 persona humbën jetën nën rrënoja, 25 në Durrës, 25 në Thumanë dhe 1 në Lezhë. Midis viktimave ishin dhe 10 fëmijë të moshave 2-10 vjeç. Ndërkohë, pas tërmetit humbën jetën edhe 2 persona nga Kurbin, njëri në spital nga plagosjet gjatë lëkundjeve dhe një tjetër përmes vetëvrasjes, për shkak të stresit post-traumatik.

Pasojat u ndjenë në shumë bashki; Shijak, Krujë, Kamëz, Kavajë, Kurbin, Lezhë, Rrogozhinë dhe Mirditë. Dëmet më të mëdha u regjistruan në Kodër-Thumanë, ku u shemb një pallat 5 katësh, ndërkohë që dëme të mëdha përjetoi edhe Laçi. 300 çadra emergjencash u ngritën pranë stadiumit të Durrësit dhe në Thumanë për t'ju ardhur në ndihmë për strehim rreth 1,000 personave. Aktualisht vijon procesi i rindërtimit në shumë bashki, ndërsa ka familje që kanë hyrë në banesat e tyre të reja si dhe shumë të tjera që pritet të futen këto ditë, duke shprehur për një jetë të re.

Gjurmët e natës së 26 Nëntorit të tre viteve më parë janë në kujtesën e kujtdo, që sot kujton se jeta dhe vdekja ndahen me pak sekonda.

New message



To I.dallaku@tiranabank.al

Subject Mesazh falenderues!

Përschendetje Ledion,

Ju vemë në dijeni se për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i dt 21.09.2019, sot u paraqitën pranë kompanisë sonë përfaqësuesit e Shoqërisë së Sigurimeve Albsig, përkatësisht Zv. Drejtori i Albsig Z. Dritan Kastrati dhe përfaqësuesit e zyrës së vlerësimit PNI-2001.

Nga kqyrja e ambienteve të kompanisë u krye verifikimi dhe konstatimi i gjithë dëmeve. Gjithashtu pas kryerjes së procedurave, u realizua dëmshpërblimi i menjëhershëm për riparimin e dëmeve.

Me zgjidhjen e kësaj procedure, falenderojmë Tirana Bank si partnerin tonë kryesor bankar si dhe Shoqërinë e Sigurimeve Albsig, përfaqësuar nga Z. Dritan Kastrati për gatishmërinë, shpejtësinë dhe korrektësinë e treguar.

Ditë të Mbarë
Gjergji Hysi
BBI GROUP



Send

Save

Cancel

New message



To rujkashi@albsig.al

Subject Procesi i trajtimit të dëmeve nga tërmeti!

Redi përschendetje,

Së pari, uroj të jeni mirë me shëndet dhe të keni kaluar sa më lehtë këto ditë të vështira për të gjithë ne.

Ju shkruaj për t'ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm si dhe për seriozitetin dhe profesionalizmin e treguar në trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

Vlerësojmë shumë partneritetin me shoqërinë tuaj dhe urojmë të forcojmë akoma më tej bashkëpunimin në të ardhmen.

Ju përschendes e uroj punë të mbarë,

Faleminderit!

Nada Vokshi | Drejtore | Departamenti i Bizneseve Alternative | Divizioni i Zhvillimit të Biznesit

Credins Bank



Send

Save

Cancel

New message



To 'Jurgen Adhami'

Subject Procesi i trajtimit të dëmeve nga tërmeti!

Përshëndetje,

Uroj që kjo korrespondencë t'ju gjejë mirë me shëndet.

Referuar situatës së rënduar të krijuar nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, ju informojmë se Albsig ka marrë të gjitha masat për nisjen e procedurave të vlerësimit dhe zhdëmtimit të dëmeve potenciale.

Ju garantojmë se të gjitha kërkesat do të shqyrtohen me seriozitet dhe ugjencë maksimale.

Gjithashtu, për çdo rast, do të koordinohemi ndërmjet nesh në lidhje me procesin e dëmshpërblimit, për të përcaktuar mënyrën e kanalizimit të fondeve.

Për çdo pyetje, sugjerim apo kërkesë tuajën mbetemi në dispozicion.

Faleminderit.

Redi Ujkashi



Send

Save

Cancel

New message



To hallaraj@albsig.al

Subject Mesazh falenderues!

Përshëndetje,

Ju falenderojmë maksimalisht në emër të bankës dhe të klientëve tanë, për ndjekjen e rasteve në një kohë shumë të shpejtë dhe për më tej me finalizimin e shqyrtimit të tyre.

Faleminderit,
Olta

Olta Mahja
Insurance Relationship Manager
Retail Products Management Department
Retail Division

 **TIRANA BANK**



Send

Save

Cancel

New message



To ejaupaj@albsig.al

Subject Procesi i trajtimit të dëmeve nga tërmeti!

Përshëndetje,

Ju njoftojmë se klienti ynë kredimarrës i siguruar pranë kompanisë suaj nëpërmjet një police sigurim prone kolateral ka pësuar dëmtime sipas tërmeteve të ndodhura.

Attach kopje e police, fotot e objektit dhe nr kontakti Z.Tom Ejelli 0696968143.

Faleminderit,
Olta

Insurance Relationship Manager
Retail Products Management Department
Retail Division



Send

Save

Cancel

New message



To omahja@tiranabank.al

Subject Njoftim demi Pavlin Ejelli, Tirana Bank Lezhe

Përshëndetje,

Lutemi na dërgoni numrin e llogarisë së klientit për të proceduar me pagesën e shumës dakortësuar për dëmin:

Mbajtësi i llogarisë bankare (emër, mbiemër)
IBAN:

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje.

Hamit ALLARAJ
Drejtör / Director
Departamenti i Dëmeve / Claims Department
Albsig



Send

Save

Cancel

PËRSE DUHEN PAKETAT E SIGURIMIT TË APARTAMENTIT/SHTËPISË/VILAVE?



Albsig mbështet gjithmonë klientët e saj dhe ju jep prioritet gjërave më të rëndësishme siç janë: familja, shëndeti dhe shtëpia. Të gjithë e dimë që jeta ndonjëherë sjell të papritura e rreziqe që mund të dëmtojnë pronën, ndaj sigurimi i shtëpisë është një domosdoshmëri.

Drejtohuni pranë zyrave të Albsig për t'u informuar mbi paketat e sigurimit të banesave dhe keni mundësi të përzgjidhni paketën që i përshtatet buxhetit të familjes suaj. Kurseni kohë dhe para, dhe jetoni të sigurt me mbështetjen dhe sigurinë e Albsig!

Nisur nga fatkeqësia natyrore e para tre viteve, siç ishin tërmetet e ndodhura në Shqipëri përkatesisht në datat 21 Shtator 2019 dhe 26 Nëntor 2019, pasojat e të cileve, qenë shumë të rënda, jo vetëm në dëme materiale, por edhe në humbje jetësh njerëzore, vëmendja në publik është shumë e gjerë sa i përket pasurive të paluajtshme.

Gjykuar rëndom si dëme, jo të shkaktuara nga tërmeti, por prej punimeve jo cilësore të ndërtimeve, të gjithë tashmë janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj kësaj çështje. I përjetuar jo vetëm si një fatkeqësi natyrore, por edhe si një lloj "catharsis" tek më pak të dëmtuarit, të gjithë janë të predispozuar për të siguruar shtëpitë e tyre e për të qenë më të qetë përse i përket tërmeteve të tjerë të mundshëm.

Sigurimi i Pronës është një segment në tregun e

sigurimeve që kategorizohet tek pjesa vullnetare. Kjo bën që ndërgjegjësimi i qytetarëve të mbetet i ulët dhe drejt shoqërive të sigurimit të shkojnë me "vullnetin" e tyre vetëm ata që blejnë apartamente me kredi.

Në të njëjtën kohë, duke qenë se së fundmi përfillet edhe hartimi i një ligji, i cili do të vendosë me detyrim siguracionin e shtëpisë, hartimi i paketave të sigurimit të apartamenteve, shtëpive dhe vilave do të shërbejë si një mënyrë edhe për njohjen e mëtejshme të rëndësisë së sigurimit dhe ofertave dhe shërbimeve që Albsig ofron, duke krijuar në të njëjtën kohë edhe një databazë kërkesash për kompaninë përse i përket këtij produkti.

Sigurimi i pronës, konkretisht shtëpisë, është një nga konceptet e reja që ka hyrë në marrëdhëniet financiare të qytetarëve me pronën e tyre. Kjo, në shumicën e rasteve, është e lidhur edhe me detyrimet e kërkuara nga marrëdhëniet me bankat, për kreditë që merren nga qytetarët për blerjen e banesave.

Përse Duhet Paketat për Sigurimin e Apartamenteve/Shtëpive/Vilave?

Dizenjimi i paketave të Sigurimit të Apartamenteve do të orientojë konsumatorët drejt çmimeve të përshtatshme për buxhetin e tyre familjar. Kjo bëhet për t'i dhënë kohë konsumatorëve që të njihen me ekzistencën e një sërë mbulimesh të ndara sipas kërkesave të tyre, njëkohësisht jo

vetëm kaq, por të regjistrojnë të dhënat e tyre online ose dhe të njoftojnë të njohurit për mundësinë e paisjeve me paketat e duhura sipas buxheteve të tyre financiare.

Kontrata e Sigurimit të Apartamenteve përfshin tre fusha bazike: Ndërtimin si Godinë, Pajisjet Shtëpiake dhe Përgjegjësinë ndaj Paleve të Treta.

NDËRTIMI, GODINA — Është shtëpia juaj: Kulmi, muret, garazhi etj. Këto duhet të sigurohen për mbrojtje kundër dëmtimeve si: zjarri, rrufeja, stuhia, tërmetet, shpërthimet, rrënja e drunjve, goditja e mjetit motorik dhe rreziqet e tjera, si vjedhjet.

PAJISJET SHTEPIAKE — Mobiliat, pajisjet elektronike dhe gjësendet e tjera brenda shtëpisë suaj, sigurohen kundër dëmtimit nga ndonjë ngjarje e paparashikueshme, si zjarri, shpërthimi i ujit, vjedhja etj.

PËRGJEGJËSITË NDAJ PALËVE TË TRETA — Kjo nënkupton që nëse fqinji më i afërt pëson aksident nga dëmet e shkaktuara në shtëpinë tuaj, për shembull lëndohet në mënyra të ndryshme, Albsig merr përsipër shpenzimet mjekësore për trajtimin e tyre.

Para se të bleni sigurimin e shtëpisë suaj, duhet të keni parasysh këtë rregull shumë të thjeshtë: SIGUROHU PËR TË RINDËRTUAR. Në rast të ndonjë ngjarje të humbjes totale, ju duhet të keni mbulesë të mjaftueshme për të rindërtuar shtëpinë apo apartamentin tuaj.

Po ashtu, ta keni parasysh që çmimet e sigurimit të shtëpisë i referohen vendbanimit, për shembull: sa m², dhe çfarë dëshironi të siguron.

Çfarë Është Shuma e Siguruar për Ndërtesën?

Është maksimumi i shumës, të cilën Albsig e kompenson në rast të dëmtimit të ndërtesës. Shuma e siguruar për ndërtesë kalkulohet në bazë të vlerës së rindërtimit të ndërtesës.

Çfarë Është Shuma e Siguruar për Pajisjet Shtëpiake?

Kjo është maksimumi i shumës, të cilën Albsig e heq në rast të dëmtimit, apo vjedhjeve të sendeve me vlerë që i keni brenda shtëpisë.

Çfarë Është Pjesa e Zbritshme?

Pjesa e zbritshme është shuma në kontratën e sigurimit, të cilën klientët e paguajnë vetë në rast të dëmit.

Paketat e Sigurimit të Apartamenteve/Shtëpive/Vilave

Paketa "Bazë"

Mbështetur në eksperiencat tona dhe bazuar në kërkesat e klientëve Paketa "Bazë" është paketa që i vjen në ndihmë çdo konsumatori për ta siguruar apartamentin/shtëpinë/vilën me mbulimet kryesore që në rast dëmi do të jetë e mbuluar me sigurim.

Çfarë Përfshihet më Konkretisht në Këtë Paketë?

Paketa "Bazë" është paketa për masën e gjerë të konsumatorëve. Kjo paketë përmban mbulimet bazë me çmime të favorshme.

Kjo paketë është hartuar t'ju vijë në ndihmë të gjithë konsumatorëve që disponojnë një apartament, shtëpi apo vilë dhe t'i sigurojë ato nga dëmet në rast zjarri, rrufeje, eksplozioni, thyerje xhamash dhe Përgjegjësinë Publike (dëmet ndaj palëve të treta-fqinjëve)

Paketa "Bazë" Mbulon Sigurimin nga:

- Zjarri
- Rrufeja
- Eksplozioni
- Thyerje Xhamash
- Rrjedhje Tubacionesh
- Përgjegësia Publike
(dëme ndaj palëve të treta-fqinjëve)

Paketa "Standard"

Albsig me paketat e duhura të sigurimit dëshiron të jetë mbështetësja kryesore për çdo individ apo familje që interesohet që ta ketë të sigurt apartamentin, shtëpinë apo vilën.

Paketa e Sigurimit "Standard" është çelësi i sigurisë së çdo kryefamiljari që i jep mundësi që në çdo rast dëmi të jetë i mbuluar edhe në rast tërmetesh!

Çfarë Përfshihet më Konkretisht në Këtë Paketë?

Sigurimi i Banesës me Paketën "Standard" është dizajnuar që t'ju sigurojë konsumatorëve një shtëpi ideale, të sigurt në rast fatkeqësie natyrore siç janë, zjarri, rrufeja, tërmeti, dhe jo vetëm.

Mbulimet e përfshira në këtë paketë mundësojnë klientët që për çdo ngjarje të shkaktuar në rast dëmi t'ju kompesohet çdo gjë. Albsig me paketat e ndryshme kujdeset që të bëjë vlerësimin e rrezikut për pronën tuaj për të ofruar kushtet dhe mbulimet e policës së sigurimit më të favorshme dhe me çmime më të volitshme në treg.

Paketa "Standard" Mbulon Sigurimin nga:

- Zjarri
- Rrufeja
- Eksplozioni
- Thyerje Xhamash
- Tërmeti
- Rrjedhje Tubacionesh
- Përgjegjësia Publike (dëme ndaj palëve të treat-fajinjëve)

Paketa "Smart"

Sa e sigurt është shtëpia jote, investimi i jetës tënde? Përjetoni qetësinë familjare duke bërë të mundur sigurimin e shtëpisë. A dini si të zgjidhni sigurimin që i përshkakatet nevojave dhe buxhetit tuaj? Pajisuni me Paketën e Sigurimit "Shtëpia e Ëndrrave" dhe shtëpia juaj do të jetë gjithmonë e sigurt dhe në rast dëmi do të kthehet në gjendjen fillestare.

Paketa "Smart" është paketa që përmbush çdo detyrim kundrejt çdo lloj dëmi. Kjo paketë përfshin të gjitha mbulimet duke cilësuar dhe vjedhjen.

Paketa "Smart" Mbulon Sigurimin nga:

- Zjarri
- Rrufeja
- Eksplozioni
- Thyerje Xhamash
- Tërmeti
- Rrjedhje Tubacionesh
- Shpërthimi
- Vjedhja
- Përgjegjësia Publike (dëme ndaj palëve të treta-fajinjëve)



ALBSIG: “BLI ONLINE SIGURIMIN E SHTËPISË, FITO FALAS KARTËN ALBSIG MED”

Nuk ke pse pret më! Tashmë me blerjen online të Sigurimit të Shtëpisë në Albsig ti mund të pajisesh me Kartën Albsig MED falas dhe ta përdorësh atë menjëherë, fizikisht në të gjithë rrjetin e klinikave të shëndetit. E gjitha kjo përfitohet nga ju vetëm në disa klikime në Albsig!


“Një muaj festë, një muaj MED Kartë Falas”, kështu është hapur sipari i vullshëm i punëve për muajin e fundit të këtij viti në Albsig. E një ide për dhurata na e japin ekspertët e shitjeve në Albsig, të cilët kanë menduar që deri më 31 Dhjetor të sjellin Sigurimin e Apartamenteve, Banesave, Shtëpive, Vilave të shoqëruara me Kartën e Klientit për Shëndetin Albsig MED falas, për çdo të interesuar që do të pajiset me këtë sigurim. Për Shoqëritë e Sigurimeve festat janë gjithmonë një mundësi që të organizojnë fushata të ndryshme marketingu për t'i promovuar produktet e tyre. Për këtë qëllim, shpesh ndodh t'u telefonojnë “sipas zgjedhjes së rastit” klientëve të ardhshëm duke ofruar karta klienti me vlerë të caktuar dhe zbritje joshëse. Festat e fundvitit janë ato që bashkojnë familjet e shqiptarëve. Njëkohësisht jo vetëm kaq, por harmonisë së festave të paharrueshme i bashkohet dhe Albsig me ofertat dhe dhuratat për klientët e saj çdo fundviti.

Albsig, Shoqëria e Sigurimeve me trendin më të madh të rritjeve në tregun e sigurimeve në Shqipëri, ka marrë një vëmendje të madhe brenda dhe jashtë vendit. Kjo jo vetëm për shkak të qëndrueshmërisë në treg dhe rritjes së vazhdueshme të paktën pesë vitet e fundit, por edhe në sajë të specialistëve dhe punonjësve më me emër, përmes të cilëve mbulohet një gamë e madhe produktesh në industrinë e sigurimeve. Ajo që Albsig zbaton me korrektësi është ofrimi i një game produktesh e shërbimesh cilësore me çmimin më të mirë në treg. Ka pak ditë që në kanalet online të shitjeve të Albsig ka nisur fushata e marketingut për Sigurimin e Shtëpive, Apartamenteve, Vilave e Banesave me çmime të favorshme të shoqëruara me Kartën e Klientit Albsig

MED. Të gjithë ata që kanë interes për sigurimin e pronave do të përfitojnë falas Kartën e Klientit Albsig MED. Albsig ka qenë dhe do të jetë gjithmonë më pranë konsumatorëve me produktet konkrete, paketat e ofertat e personalizuara për të gjitha target grupet e interesit. Urojmë që mos të përsëritet më situata në të cilën u gjenden shqiptarët në Nëntorin e vitit 2019, ku tërmeti i fuqishëm tronditi jo vetëm themelet e shtëpive të gjithësecilit prej nesh, por edhe sigurinë e jetës së konsumatorëve.

Për këtë Shoqëria e Sigurimit Albsig, pjesë e Kastrati Group, kujtohet se përgjatë dy tërmeteve të vitit 2019 ishte një tjetër mundësi për të treguar aftësinë e saj pague, mbajtjen e fjalës kundrejt të siguruarve të cilët, kanë marrë dëmshpërblimin e tyre deri tek i siguruari i fundit. Mbi të gjitha, vlerën më të madhe e ka siguria që në ditë të tilla është një ndihmë e rëndësishme për atë që e ka, kundrejt një pagese të papërfillshme në krahasim me dëmin që mund të të krijojë një fatkeqësi natyrore, zjarri, përmbytjet apo çdo aksident tjetër.

Albsig.sh.a është e vetmja shoqëri sigurimesh në treg që ka numrin më të vogël të dëmeve pezull. Albsig pati një organizim burimesh njerëzore dhe financiare të padëgjuar deri në vitin 2019. Në shifra dhe numër kërkesash, ngjarjet e tërmeteve sollën një fluks të lartë nga të siguruarit, por ajo që vuri në provë shoqërinë Albsig ishte shifra e lartë e dëmshpërblimit të individëve, subjekteve dhe bizneseve. Ky proces i suksesshëm rriti besueshmërinë dhe bëri që Albsig të ketë një rol kyç në këtë proces. Për të mbajtur të njejtin trend besueshmërie, Albsig ka hartuar politika dhe strategji shitjesh në kuadër të mirëqenies së konsumatorëve.





Med-Kartë, Mundësi Lehtësuese për Shëndetin

Për të shpërblyer të gjithë klientët e saj Albsig ofron Kartën e Shëndetit MED, e cila përveç lehtësirave të shumta bën të mundur dhe ofrimin e menjëhershëm të përgjigjeve online të çdo procesi. Jo vetëm kaq, por ata që do të pajisen me këtë kartë ju jep mundësinë të kursejnë nga 20–30% zbritje në analizat dhe vizitat mjekësore dhe njëkohësisht dhe 10% ulje dhe në ndërhyrjet kirurgjikale. Duke qenë të pajisur me Kartën MED përfitoni edhe nga promocionet e Albsig, si edhe nga oferta të shumta gjatë gjithë vitit.

Si Mund të Pajiseni me Kartën MED?

Pajisja me Kartën MED është shumë e thjeshtë, mjafton të plotësoni formularin online ose të paraqiteni në një nga zyrat e shitjeve të Albsig dhe brenda një kohe shumë të shkurtër, do të pajiseni me Kartën MED. Për Kartën MED nuk duhen procedura e dokumenta. Mjafton që klienti të shkojë me kartën e identitetit pranë zyrave të shitjes së Albsig dhe menjëherë do të pajiset me këtë kartë. Karta MED do të jetë çelësi i mundësive për klientët e shëndetit dhe jo vetëm, të cilët do të kenë mundësi dhe akses të jenë prezentë në të gjithë rrjetin spitalor ku ata duan dhe ndjehen komod.

Çmimi Konkurrues dhe Favorizues për Klientët

Korrektësia e ALBSIG, dhe dëmshpërblimet në kohë rekord, janë shpërblyer me besim të klientëve dhe bizneseve ndaj shoqërisë. Mungesa e kulturës së sigurimeve ka bërë që kërkesa për produkte sigurimi lidhur me Sigurimin e Shëndetit, mbetet tepër e ulët në Shqipëri. Menjëherë pas pandemisë është parë një kërkesë në rritje e klientëve individë, më së shumti për Sigurimin e Shëndetit, kërkesë e cila u mbështet me paketat individuale e familjare shumë konkurruese dhe me çmime favorizuese. Një ndër to është Karta MED e dizenuar në mënyrë të tillë që të jetë në xhepin e çdo shqiptari. Ajo kushton vetëm 10 Euro dhe favorizon çdo qytetar që të pajiset me të.

Vlefshmëria

Parandalimi është më i mirë se kurimi. Është kjo shprehja që na përndjek kudo përsa i përket mbrojtjes së shëndetit. Mjafton të pajisesh me Kartën MED dhe për një periudhë 1-vjeçare do të jesh i sigurt dhe komod për çdo të papritur që mund t'ju ndodhë ju ose familjareve tuaj. Duke blerë Kartën e Shëndetit MED në Albsig, për vetëm 10 Euro, për 1 vit ju bëheni mbartës i një sërë privilegjesh, duke filluar që nga konsulta mjekësore falas, zbritje në një sërë ekzaminimesh mjekësore dhe çmime preferenciale.

Aktualisht shoqëria ka hedhur në treg Kartën MED, një skemë shpërblimi i Albsig për klientët e shëndetit dhe

jo vetëm. Klientët e Albsig gëzojnë një trajtim të veçantë, ata trajtohen nga punonjësit me një kujdes të veçantë, derisa në shërbimet e tyre kryejmë me efikasitet dhe përgjegjësi të lartë.

Dhe në anën tjetër klientët në çdo kohë mund të ankohen për çdo shërbim nëse nuk ka qenë në nivel dhe çdo lëshim eventual i mundshëm i policave të sigurimit. Gjithsesi ankesa e tyre trajtohet me shumë kujdes kur merret parasysh motoja e Albsig që klienti çdo herë ka të drejtë.

Vlen të theksohet fakti se Shoqëria e Sigurimeve Albsig ka menduar edhe për klientët e saj që nuk kanë kohë të vijnë në zyrat e shitjeve duke ju mundësuar atyre pyetesorët e sigurimeve të ndryshme që mund t'i plotësojnë online përmes faqes sonë të internetit www.albsig.al, dhe aty do të mund të gjejnë edhe informacione të ndryshme rreth sigurimeve që u interesojnë dhe gjithashtu mund të blejnë online produktet që ju nevojiten.





ALBSIG, MBËSHTET PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË BUJQËSISË, BLEGTORISË DHE KOPSHTARISË 2022.

Fundin e muajit Nëntor, Albsig e përmbylli me aktivitete të rëndësishme, ku një ndër to ishte dhe pjesëmarrja në edicionin e tretë të Panairit Ndërkombëtar të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Kopshtarisë 2022 nga Expocity Albania.

Ky panair bëri bashkë aktorët më të rëndësishëm të sektorëve kombëtar dhe ato ndërkombëtar. Qëllimi kryesor i këtij eventi ishte krijimi i mundësive për bashkëpunime biznesi për çdo fermer dhe të interesuarit e këtij sektori. Në Agrotech Expo 2022 morën pjesë kompani nga vende të ndryshme si Kosova, Maqedonia e Veriut, Greqia, Italia Serbia si dhe nga Gjermania.

Në ceremoninë e hapjes, drejtoresha ekzekutive e Expocity Albania, Aulona Hoxha, u shpreh se numri i madh i stendave në këtë panair dëshmon qartë rëndësinë për bashkëpunim në Agrobiznes. Përgjatë datave 24-26 Nëntor 2022 vizituan Panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Kopshtarisë, në Expocity Albania, Tiranë një numër i konsideruar konsumatorësh ku u ndalën dhe në stendën e Albsig. "Së bashku Sot për një të Nesërme të SIGURT!", ishte dhe slogani i Albsig pjesëmarrës në eventin e organizuar. Edicioni i tretë i Panairit Agrotech në ExpoCity ka si synim të mbledhë së bashku aktorë të zinxhirit prodhues dhe përpunues të bujqësisë dhe ushqimit duke mos lënë pa cekur dhe tregun e sigurimeve.

Organoizatorët e këtij panairi u bënë ftesa të gjithë konsumatorëve dhe jo vetëm që t'i bashkohen këtij panairi si një mundësi për t'u njohur me operatorë të tjerë të sektorit dhe për të krijuar mundësi të reja bashkëpunimi. Bashkë për Bujqësinë, Bashkë për Shqipërinë!



ALBSIG JETË: NISMË NË FAKULTETE NË KUADËR TË “SIGURIMI JETË STUDENTË”

“Rëndësia e sigurimit të jetës tek brezi i ri”, kjo ka qenë tema kryesore e takimit të zhvilluar nga Shoqëria e Sigurimeve Albsig Jetë me studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale.

Kjo nismë e ndërmarrë nga Albsig Jetë ka bërë që një pjesë e madhe e studentëve të ndërgjegjësohen përsa i përket rëndësisë së Sigurimit të Jetës. “Keni një jetë për të bërë dhe një varg ëndrrash për të realizuar, një të ardhme që ju pret, por pa qenë të sigurt që ky rrugëtim mund të bëhet edhe më i vështirë.

E ardhmja e sigurt është në dorën tuaj”, ky ka qenë mesazhi që Albsig Jetë u ka dhënë studentëve në takimin e zhvilluar në ambientet e këtij fakultetit. E gjithë tema e diskutimit u bazua se sa njohuri kanë studentët për “Sigurimin e Jetë Studentë”.

Nisma e ndërmarrë nga drejtuesit e Shoqërisë së Sigurimeve Albsig Jetë do të përhapet në të gjitha Universitetet në Tiranë dhe në rrethe për të bërë të mundur sadopak edukimin e të rinjve mbi sigurimet.

Një falenderim i veçantë shkon për stafin e fakultetit si dhe për të gjithë studentët pjesëmarrës, të cilët ishin të gatshëm të mësonin për të rejtat në këtë fushë dhe të jepnin dhe ato mendimet e tyre.

“E ardhmja e sigurt është në dorën tuaj”





☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL